

VENDIM
Nr. 736, datë 8.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 113, DATË 17.2.2007, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN DHE
PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMITETIT
NDËRSEKTORIAL PËR MBROJTJEN NGA PRODUKTET E DUHANIT (KNMSHPD)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 113, datë 17.2.2007, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---------|
| a) Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë | anëtar; |
| b) Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë | anëtar; |
| c) Zëvendësministri i Brendshëm | anëtar; |
| d) Kryetari i Këshillit Kombëtar i Radios dhe Televizionit Publik Shqiptar | anëtar; |
| ç) Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit | anëtar; |
| dh) Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik | anëtar; |
| e) Kryeinspektori Sanitar Shtetëror | anëtar; |
| ë) Drejtori i Policisë Bashkiake Tiranë | anëtar; |

“1. Ngritjen e Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD), me kryetar ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me këtë përbërje:

Funksionet e sekretarit të KNMSHPD-së të kryhen nga Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik.”.

2. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Shpërblimi për pjesëmarrësit, për çdo mbledhje, bëhet sipas vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.”.

3. Në pikën 7 dhe në të gjithë përmbajtjen e këtij vendimi, emërtimi “Ministri i Shëndetësisë” zëvendësohet me “Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama